



KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 04/10/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), përpara meje Noteres Sofika K. Braka, me zyrë në rrugën "Ismail Qemali", pallati 11/1, u paraqitën personalisht palët e poshtëshënuara për lidhjen e kësaj kontrate shitblerjeje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

SHITËSI: Shoqëria "**International Rating Service**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 29.03.2018, me NUIS: L81603032A, me adrese Rruga "Ismail Qemali", ndertesa 14, hyrja 4, apartamenti 5, Tirane, me ortak te vetem, Shoqëria "**Vero Consulting**" Shpk, themeluar si person juridik në datën 16.03.2018, me NUIS: L81603032A, e perfaqesuar nga administratori dhe ortaku i vetem **z. Denis Kuçi**, atesia: Astrit, i datëlindjes 03.09.1994, lindur dhe banuese në Durrës, identifikuar me Letërnjoftimin ID nr. 029868047 dhe nr. personal J40903068A, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

BLERËSIT: **zj. Joana Shera**, atesia: Hasan, e datëlindjes 22.03.1991, lindur e banuese ne Tirane, Rruga "Teki Selenica", identifikuar me Leternjoftimin ID nr. 029968998 dhe nr. Personal J15322055H, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

NENI 1

Shitësi është ortak me zotërues i 1 kuote, me pjesëmarrje 100% të kuotave, të shoqërisë "**International Rating Service**" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 29.03.2018, me NUIS: L81603032A, me seli në Tiranë, Rruga "Ismail Qemali", apartamenti 5, shk. 1, pallati 356.

1.1 Këto kuota të shoqërisë, Shitësi ia shet Blerësve te cilët pranojnë t'i blejnë ato sipas çmimit dhe kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

1.2 Nga këto kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë "**International Rating Service**" Sh.p.k. që ai zotëron, Shitësi u shet Blerësve 100% të tyre, me vlerën e tyre të cilët pranojnë t'i blejnë ato, sipas kushteve dhe proporcionit të përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

NENI 2

2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësit, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "**International Rating Service**" Sh.p.k., është në vlerën e tyre nominale.

2.2 Ky çmim është likuiduar nga Blerësit kundrejt Shitësit, dhe Shitësi deklaron se e ka marrë këtë çmim dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tij ndaj Blerësve.

NENI 3

3.1 Blerësit, i blejnë kuotat që shet Shitësi, në raportin e mëposhtëm:

Joana Shera, blen 100% të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 100,00 Lekë (njeqind), dhe bëhet ortak me 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "International Rating Service" Sh.p.k.

3.3 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të shoqërisë "International Rating Service" Sh.p.k., Blerësve u transferohen proporcionalisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në shoqëri.

NENI 4

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon Blerësit, nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ai i shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

NENI 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje me nga dy fletë, me të njejtën vlerë ligjore. Une noterja, pasi iu bëra me dijeni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë shitblerjeje të kuotave që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Une noterja e legalizoj sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Shoqëria "International Rating Service" Sh.p.k.

Ortak i vetem

Shoqëria "Vero Consulting" Sh.p.k.

Ortak i vetem dhe administrator

DENIS KUÇI

Denis Kuçi

kuçi
18

BLERËSI

JOANA SHERA

Joana Shera
Shera

NOTERE
Sofika K. BRAKA

Takosa e Pullës
Pagua



International Rating Service
Nipt: L81603032A